


AL

UDHËZIME TË HOLLËSISHME PËR PËRDORIMIN E FURRËS ELEKTRIKE

gorenje



Ju falënderohemi për mirëbesimin tuaj në rastin e blerjes së aparatit tonë.

Për përdorimin më të lehtë të prodhimit ju bashkangjesim udhëzime të hollësishme. Le të ju ndihmojnë që sa më parë të njoftoheni me aparatit tuaj të rinj.

Binduni që keni pranuar aparat të padëmtuar. Nëqoftëse konstatoni dëmtim transporti, ju lutemi që të kontaktoni shitësin ku e keni ble aparatit ose me deponë rajonale prej ku ka ardhur. Numrin telefonik e gjeni në faturë, respektivisht në fletëfurnizim.

Udhëzimet për instalim dhe aderim janë të bashkangjitura në fletën e veçantë.

Udhëzimet për përdorimin e paratit mund t'i gjeni edhe në WEB faqen tonë:

www.gorenje.com / < <http://www.gorenje.com> />



informata të rëndësishme



këshilla, vërejtje


PËRMBAJTJA

4 FURRA ELEKTRIKE 7 Të dhënat teknike 8 Njësia e komandimit 10 PARALAJMËRIME TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË 11 Para aderimit të furrës	HYRJE
12 PARA PËRDORIMIT TË PARË	PËRGATITJA E PARË E APARATIT
13 HAPAT E PJEKJES (1 - 6) 13 Hapi i 1: KYÇJA E PARË 14 Hapi i 2: PËRZGJEDHJA E MENYVE ELEMENTARE TË PJEKJES DHE RREGULLIMEVE. 22 Hapi i 3: NISJA E PJEKJES 22 Hapi i 4: PËRF. I PJEKJES DHE SHKYÇJA E FURRËS 24 Hapi i 5: PËRZGJ. E FUNKSIONEVE SHITESË 27 Hapi i 6: PËRZGJEDHJA E RREGULLIMEVE TË PËRGJITHSHME 29 PËRSHKRIMI I SISTEMEVE DHE TABELËS SË PJEKJES	HAPAT E PJEKJES
44 PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA 45 Pastrimi klasik i furrës 46 Pastrimi i furrës me funksionin aqua clean 47 Heqja dhe pastrimi i udhëzuesve prej teli 48 Pastrimi i tavanit të furrës 49 Nxjerrja dhe inst. I derës së furrës 51 Nxjerrja dhe instalimi i xhamit të derës 52 Ndërrimi i llambës	PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA
53 TABELA E PENG. DHE GABIMEVE 54 HUDHJA	ZGJIDHJA E VËSHTIRËSIVE
55 TESTIMI I USHQIMEVE	TË TJERA

FURRA ELEKTRIKE

(PËRSHKRIMI I FURRËS DHE PAJISJET - VARËSISHT NGA MODELI)

Në fotos është i përshkruar njëri nga modelet e aparateve instaluese. Aparatet për të cilët janë të përpiluara këto udhëzime, mund të përmbajnë pajisje të ndryshme, prandaj mund të jenë të përshkruara edhe funksione dhe pajisje të cilat aparati i juaj nuk i përmban.



UDHËZUESIT PREJ TELI

Udhëzuesit prej teli mundësojnë gatitjen e ushqimit në katër nivele (merrni në konsiderim që nivelet llogariten prej poshtë naltas).

Udhëzuesit e 4 dhe të 5 janë të dedikuar pjekjes nën skarë.

UDHËZUESIT TELESKOPIK

Me udhëzuesit teleskopik tërheqës mund të jenë të pajisur nivelet 2., 3. dhe 4..

Nivelet tërheqëse mund të jenë të prodhuar me udhëzues pjesërisht ose krejtësisht tërheqës.

TASTET E DERËS SË FURRËS

Tastet shkyçin ngrohjen e furrës dhe ventilatorin, kur hapet dera e furrës gjatë funksionimit. Kur mbyllet dera, tastet përsëri kyçin ngrohjen.


VENTILATORI PËR FTOHJE

Në aparat është i instaluar ventilatori për ftohje, i cili ftoh shtëpizën dhe pllakën e komandimit të aparatit.

FUNKSIONIMI I VAZHDUAR I VENTILATORIT PËR FTOHJE

Pas shkyçjes së furrës, ventilatori për ftohje punon edhe një kohë të shkurtër për të ftoh furrën. (Funksionimi i vazhduar i ventilatorit për ftohje varet nga temperatura në qendrën e furrës).

PAJISJET E FURRËS (Varësisht nga modeli)



TEPSIA PREJ QELQI përdoret për pjekjen e ushqimeve me të gjitha sistemet e furrës. Atë mund ta përdorni edhe si pjatë për servim.




GRILA (shosha) përdoret për pjekje në skarë, ose mbi të vëndoni enë ose tepsinë me bylmetin.



Në grilë është kapës sigurues, prandaj te tërheqja nevojitet ta çojmë lehtë grilën nga ana e parë.




TEPSIA E CEKËT përdoret për pjekjen e ëmbëlsirave dhe kulaçeve.




TEPSIA E THELLË përdoret për pjekjen e mishit dhe ëmbëlsirave të njoma. Përdoret edhe si enë për tubimin e yndyrës.



Tepsia e thellë, gjatë pjekjes kurrë të mos jetë në udhëzuesin e pare, përveç se kur piqui në skarë ose përdorni hellin dhe tepsia e thellë është dedikuar për tubimin e yndyrës.



Te udhëzuesit prej teli, grilën dhe tepsitë gjithmonë futni në vanën udhëzuese, të cilën e caktojnë profilat prej teli.



Te udhëzuesit teleskopik tërheqës së pari tërhiqni udhëzuesit e një niveli, në të vëndoni grilën ose tepsitë dhe me duar i shtyni deri në fund.



Derën e furrës e mbyllni kur udhëzuesit teleskopik janë të shtyera deri në fund.



Aparati dhe disa pjesë qasëse gjatë pjekjes nxehen. Te gatimi përdorni doreza mbrojtëse.

TË DHËNAT TEKNIKE

(VARËSISHT NGA MODELI)

XXXXXX	220-240V ~	Pn _{max} : 3.5 kW	TN XXXXX
TIP: XXXXXX	220V-240V, 50/60Hz		
ART. Nr:			
SER. Nr: XXXXXX			

Tabela me shënimet elementare për aparatin është e instaluar në skajin e furrës dhe shihet kur e hapni derën e aparatit.

NJËSIA E KOMANDIMIT




1 SHKYÇJA

2 BUTONI
KTHEHU

Prekja e shkurtër:
kthyerja në menynë
parprake

3 INDIKATORI
për shfaqjen
dhe përzgjedhjen e
rregullimeve.

Prekja e shkurtër:
kthyerja në menynë
elementare



KUJDES:

Që të përgjigjen butonet më mire, prekni me sipërfaqen sa më të madhe të gishtit. Te çdo prekje, paraitet sinjali zanor.

Nëpër meny lëvizni me rrëshqitjen e gishtit naltas ose poshtas, majtas ose djathtas.

Përzgjedhjen e konfirmoni me prekje.

PARALAJMËRIME TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË



ME KUJDES LEXONI UDHËZIMET DHE RUANI PËR NË TË ARDHMEN

Fëmijët me moshë tetë vjet dhe më shumë dhe personat me aftësitë e dobësuar fizike, sensorike dhe mentale ose me njohuri të mangshme dhe experience, mund të përdorin këtë aparat nën mbikqyrjen adekuate ose nëqoftëse kanë marrë udhëzime përkatëse sa i takon përdorimit të sigurtë të aparatit dhe i kuptojnë rreziqet që kanosen lidhur me aparatin. Le të mos lozin fëmijët me aparatin. Le të mos pastrojnë fëmijët aparatin dhe të mos zbatojnë punë mirëmbajtjeje në të pa mbikqyrje adekuate.

PARALAJMËRIM: Aparati dhe disa pjesë qasëse të aparatit gjatë përdorimit nxehen shumë. Kujdeseni që të mos prekni elementet për nxehje. Fëmijët më të rinj se 8 vjet le të jenë tërë kohën nën mbikqyrje.

Gjatë përdorimit, aparati nxehet shumë. Kujdeseni që të mos prekni elementet nxehëse të furrës.

PARALAJMËRIM: Gjatë përdorimit, pjesët qasëse mund të nxehen shumë. Mos lejoni fëmijët në afërsi të furrës.

Përdorni vetëm sondën temperaturiale që rekomandohet për përdorim në këtë furrë.

PARALAJMËRIM: Para ndërrimit të llambës, binduni që aparati është i shkyçur nga rrjeta elektrike, kështu do të parandaloni rrezikun e goditjes elektrike.

Për pastrimin e furrës mos përdorni lëndë pastruese të vrazhdëta ose rende të mprehta metalike, sepse me ata mund të dëmtoni sipërfaqen ose shtresën mbrojtëse të emailit. Për shkak të llojit të tillë të dëmtimeve, xhami mund të pëlcas.

Mos pastroni aparatit me avull të nxehtë ose me pastrues me shtypje të lartë, ato mund të shkaktojnë goditje elektrike. Aparati nuk është i dedikuar për komandim me orët e jashtme programuese ose me sisteme tjera të posaçme për mbikqyrje.

Aparati është i dedikuar për përdorim në amvisëri. Mos e përdorni për asnjë qëllim tjetër, p.sh. për ngrohjen e hapësirave, terjen e kafshëve shtëpiake, letrës, stofave ose bimëve jeshile, sepse në këto raste ekziston rreziku i dëmtimeve ose zjarrit.

Aparatin ka të drejtë ta kyç vetëm shërbimi servisor ose profesionisti. Te ndërhyrjet joprofesionale dhe ndreqjet e aparatit ekziston rreziku i lëndimeve serioze të trupit dhe dëmtimeve të aparatit.

Kabllotë kyçëse të aparatit që gjenden në afërsi të aparatit, nëqoftëse kapen me derën e furrës, dëmtohen dhe shkaktojnë kontakt të shkurtër. Prandaj, kabllotë kyçëse të aparateve tjera le të jenë larg.

Nëqoftëse është e dëmtuar kabloja furnizuese, atë le të ndërrojë prodhuesi ose serviseri i tij që t'i shmangeni rrezikut.

Mos mvëshni furrën me foli nga alumina dhe mos vëndoni tepsi dhe enë tjera në fundin e furrës, sepse mvëshja nga folia parandalon qarkullimin e ajrit në furrë, frenon pjekjen dhe asgjëson emailin.

Gjatë funksionimit të furrës, dera e saj nxehet shumë. Për mbrojtje shtesë është instaluar shtesë xhami i tretë, i cili ul temperaturën sipërfaqësore të xhamit të jashtëm të derës së furrës (vetëm te disa modele).

Menteshetë e derës së furrës mund të dëmtohen te ngarkimi i saj i fuqishëm. Në derën e hapur të furrës të mos vëndoni enë të rënda gjatë pastrimit të brendësisë së furrës. Kurrë mos ngjitni këmbën mbi derë të hapur të furrës dhe mos lejoni fëmijve të ulen mbi të.

Funksionimi i pajisjes është i sigurt me ose pa udhëzuesit e platformave.

Kujdeseni që vanat ajrosëse të mos mbulohen ose ndryshe të vështirësohen.

PARA ADERIMIT TË FURRËS



Para aderimit të aparatit, nevojitet të lexoni me saktësi udhëzimet për përdorim. Eliminimi i prishjes, resp. reklamacionit që është shfaqur për shkak të aderimit ose përdorimit të gabimshëm të aparatit, nuk janë lëndë e garancionit.

PARA PËRDORIMIT TË PARË

Pas pranimit të aparatit, nga furra nxjerrni të gjitha pjesët, kyçur edhe pajisjet e transportimit. Të gjithë pjesët e pajisjes pastroni me ujë të ngrohtë dhe me lëndë pastruese të rëndomta. Mos përdorni lëndë pastruese të vrazhdëta.

Te nxehja e parë e furrës, zbërthehet duhmë karakteristike “si e re”, prandaj gjatë nxehjes hapësirën mirë ta ajrosni.

HAPAT E PJEKJES (1 - 6)


HAPI I 1: KYÇJA E PARË

RREGULLIMI I ORËS

Pas kyçjes së parë të aparatit në rrjetën elektrike ose pas dështimit të gjatë të furnizimit me energji elektrike, në indikator shfaqet rregullimi i ORËS. Rregulloni kohën ditore.



Nëpër meny lëvizni me rrëshqitjen e gishtit naltë dhe poshtë.



Me prekjen e indikatorit rregulloni ORËN – kohën.

Përzgjedhjen e konfirmoni me shtypjen e butonit START/STOP.



Furra funksionon edhe nëqoftëse nuk e rregulloni kohën ditore, por në këtë rast nuk mund të rregulloni funksionet kohore (shiqo kapitullin PËRZGJEDHJA E FUNKSIONEVE KOHORE). Pas ca minutash të mosaktivitetit, aparati kalon në gjendje të pushimit – Standby.

NDRYSHIMI I RREGULLIMEVE TË ORËS

Kohën ditore mund të ndryshoni, kur nuk është aktive asnjë funksion kohor (shiqo kapitullin PËRZGJEDHJA E RREGULLIMEVE TË PËRGJITHSHME).

PËRZGJEDHJA E GJUHËS

Nëqoftëse gjuha në të cilën u shfaqen tekstet në indikator nuk u pëlqen, përzgjedhni tjetrën. Fabrikisht është rregulluar në gjuhën angleze.



Kur e prekni gjuhën e dëshiruar, ai zmadhohet.




NË MENYNË ELEMENTARE ktheheni me prekjen në butonin ↩

HAPI I 2: PËRZGJEDHJA E MENYVE ELEMENTARE TË PJEKJES DHE RREGULLIMEVE.

Pjekjen mund të drejtoni në shumë mënyra:



Nëpër meny lëvizni me rrëshqitjen e gishtit majtas dhe djathtas.



Me preken përzgjedhni mënyrën. Naltas shfaqet emri i menysë së përzgjedhur.

Mënyra profesionale

Këtë mënyrë e përdorni kur dëshironi të përgatitni llojin e dëshiruar dhe sasinë e ushqimit. Të gjitha rregullimet i përzgjedhni vetë.

Automatikisht


Në këtë mënyrë së pari përzgjedhni llojin e gjellës e pastaj ushqimin e përzgjedhur me rregullimin automatik të sasisë, shkallës së pjekjes dhe përfundimin e funksionimit.

Programi ju ofron assortimen të madh të recetave të pararregulluara, të konfirmuara nga ana e gjellëbërësve dhe profesionistëve për ushqim.

Recetat e mia

Kjo mënyrë ju mundëson përgatitjen e gjellës sipas dëshirës, çdoherë me hapat dhe rregullimet e njejta. Recetat tuaja të adhuruara personale i ruani në memorjen e furrës dhe në të ardhmen vetëm i kyçni.

A) PJEKJA ME PËRZGJIDHJEN E LLOJIT TË USHQIMIT (mënyra Automatikisht)



Përzgjedhni mënyrën e pjekjes **Automatikisht**.



Përzgjedhni llojin e gjellës dhe pastaj gjellën.



Shfaqen vlerat e pararegulluara.

- **sasia**
- **shkalla e skuqjes (intenziviteti)**
- **koha e pjekjes** (koha e përfundimit të pjekjes është e cekur në ngjyrën hi). Mund të ndryshoni sasinë dhe shkallën e stërkuqjes. Vlerat e përzgjedhura ngjyrosen me ngjyrë të kuqe.



RREGULLIMET SHITESË.

I përzgjedhni me preken në shiritin e sipërm, resp. emrin.



- **ndriçimi i furrës**



- **përshkrimi i përgatitjes së recetës dhe përbërsit për recetën e përzgjedhur.**



- **hapi programor** (shiqo kapitullin PËRGATITJA NË HAPA).



- **rregullimi i përfundimit të pjekjes** (shiqo kapitullin FUNKS. KOHOR).



- **paralajmëruesi zanor** (shiqo kap. RREGULLIMET SHITESË).

PARANGROHJA

Procesi i përgatitjes së disa gjellave në mënyrën **Automatikusht** përmban edhe funksionin e parangrohjes. Në indikator shfaqet simboli .

Kur e përzgjedhni gjellën, shfaqet vërejtja **"Programi i përzgjedhur përmban parangrohje. Parangrohja ka filluar. Gjellën akoma mos e futni në furrë."** Në indikator pulson simboli.


Kur arrin temperatura e rregulluar, parangrohja përfundon dhe paraqitet sinjali zanor, të cilin mund ta shkyçni me shtypjen e cilitdo buton ose pas 1 minute shkyçet vetë.

Në indikator shfaqet vërejtja **"Parangrohja ka përfunduar. Ju lutemi, futni gjellën"**. Hapni derën. Programin vazhdon pjekjen me rregullimet e përzgjedhura.



Kur është i rregulluar funksioni i parangrohjes, nuk mund të përdorni funksionin e kycjes së vonuar.

B) PJEKJA ME PËRZGJEDHJEN E MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT (Mënyra profesionale)



Përzgjedhni **mënyrën profesionale** të pjekjes.



Përzgjedhni rregullimet personale elementare:

- **sistemi i nxehësve**
- **temperatura në furrë**

Vlerat e përzgjedhura ngjyrosen.

Me prekjen e simbolit  përzgj. funksionimet - kohën e pjekjes (koha e përfundimit të pjekje është shfaqur në ngjyrë hiri).



RREGULLIMET SHITESË:

I përzgjedhni me prekjen e shiritit të mësipërm, resp emrin.



- **ndriçimi i furrës**



- **parangrohja**



- **program hapor** (shiqo kapitullin PËRGATITJA NË HAPA)



- **vërejtësi zanor** (shiqo kapitullin RREGULLIMET SHITESË)



 Nëqoftëse përzgjedhni Zgjatja, në rregullimet shtesë mund të përzgjedhni edhe **Kyçja e vonuar** (shiqo kapitullin FUNKSIONET KOHORE).

Prekni butonin START.

Në indikator shfaqen të gjitha rregullimet e përzgjedhura.



Në indikator shihen temperatura në rritje në furrë dhe koha e pjekjes.

PARANGROHJA

Parangrohjen  e përdorni nëqoftëse dëshironi të ngrohni furrën sa më pare në temperaturën e dëshiruar. Me përzgjedhjen e simbolit kyçni funksionin e parangrohjes dhe shfaqet paralajmërimi **"Parangrohja ka filluar. Gjellën akoma mos e futni në furrë."** Në indikator pulson simboli. Kur arrin temperatura e rregulluar, parangrohja përfundon dhe paraqitet sinjali zanor, të cilin mund ta shkyçni me shtypjen në cilindo buton ose pas 1 minute shkyçet vetë.

Në indikator shfaqet paralajmërimi **"Parangrohja ka përfunduar. Ju lutemi, futni gjellën".** Hapni derën. Programi vazhdon pjekjen në bazë të rregullimeve të përzgjedhura.



Kur është i rregulluar funksioni i parangrohjes, nuk mund të përdorni funksionin e kyçjes së vonuar.

SISTEMET E PJEKJES (vaarësisht nga modeli)

SISTEMI	PËRSHKRIMI	TEMPERATURA E PARARREGULLUAR (°C)
SISTEMI I FURRËS		
	NXEHËSI I EPËRM DHE I POSHTËM Nxehtësit në anën e epërme dhe të poshtme të furrës rrezatojnë njëtrajtshëm nxehtjen në brendësi të furrës. Pjekja e parorive ose mishit është e mundëshme vetëm në një nivel.	200
	NXEHËSI I EPËRM Nxehtësinë e rrezaton vetëm nxehtësi në anën e sipërme të furrës. Përdoret kur dëshironi të skuqni më shumë anën e sipërme të gjellës.	150
	NXEHËSI I POSHTËM Nxehtësinë e rrezaton vetëm nxehtësi në anën e poshtme të furrës. Përdoret kur dëshironi të skuqni më shumë anën e poshtme të gjellës.	160
	SKARA Funksionon vetëm infra nxehtësi, i cili është pjesë e skarës së madhe. Përdoret për pjekje nën skarë për sasi të vogla të bukëve të mbimbushura dhe suxhukëve të birrës ose stërkuqjen e toastit.	240
	SKARA E MADHE Funksionojnë nxehtësi i epërm dhe infra nxehtësi. Ngrohjen direkte e transmeton infra nxehtësi i instaluar në tavanin e furrës, për rritjen e efikasitetit të nxehtjes është i kyçur edhe nxehtësi i epërm. Përdoret për pjekje nën skarë për sasi të vogla të bukëve të mbimbushura, mishit ose suxhukëve të birrës dhe për stërkuqjen e toastit.	240
	SKARA ME VENTILATOR Funksionojnë infra nxehtësi dhe ventilatori. Përdoret për pjekjen e mishit në skarë dhe pjekjen e copave të mëdha të mishit ose zogjve në një nivel të furrës. Është e përshtatshme edhe për gratinim dhe arritje të rreshkjes.	170
	AJRI I NXEHTË DHE NXEHËSI I POSHTËM Funksionon nxehtësi i poshtëm dhe nxehtësi rrethor me ventilator. Përdoret për pjekjen e picës, ëmbëlsirave të njoma, tortave nga frutat dhe brumi i tharmit dhe i brishtë në më shumë nivele.	200
	360 AJRI I NXEHTË Funksionojnë nxehtësi rrethor dhe ventilatori. Ventilatori në murinë e fundit kujdeset për qarkullimin permanent të ajrit të nxehtë rreth fërlikut ose ëmbëlsirave. Përdoret për pjekjen e mishit dhe ëmbëlsirave në më shumë nivele.	180
	EKO PJEKJE ¹⁾ Optimizon shpenzimin e energjisë gjatë pjekjes. Përdoret për pjekje të mishit dhe ëmbëlsirave.	180
	NXEHËSI I POSHTËM DHE VENTILATORI Përdoret për pjekjen e ëmbëlsirave të ulëta dhe zierjen e pemëve dhe perimeve.	180
	SAMODEJNA PEKA MESA Me avtomatskim peçenjem deluje zgornji grelec v kombinaciji z infra in okroglim grelom. Uporablja se za vse vrste mesa.	180

¹⁾ Funkzioni në fjalë përdoret për përcaktimin e klasës efikase energjike në përputhje me standardin EN 60350-1.

Te funksioni në fjalë nuk shfaqet temperatura faktike në furrë, për shkak të algoritmit të posaçëm të funksionimit të aparatit dhe shfrytëzimit të ngrohtësisë së mbetur.

FUNKSIONET KOHORE - ZGJATJA



Në mënyrë elementare **Profesionale** dhe mënyrën **Automatikiisht** me përzgjedhjen e simbolit mund të përzgjedhni funksionet kohore.



Rregullimi i zgjatjes së funksionimit

Te mënyra në fjalë caktoni kohën se sa gjatë të funksionojë furra. Rregulloni kohën e dëshiruar të funksionimit dhe konfirmoni përzgjedhjen. Kësaj i përshtatet shfaqja e përfundimit të funksionimit. Shtypni START për fillimin e pjekjes. Në indikator janë të shfaqura të gjitha rregullimet e përzgjedhura. Të gjitha funksionet kohore mund t'i shkyçni ashtu që kohën e përzgjedhur ta rregulloni në "0".



Rregullimi i kyçjes së vonuar të furrës

Te mënyra në fjalë caktoni kohën se sa gjatë të funksionojë furra (zgjatja) dhe në cilën orë të ndërpreen funksionimin (përfundimi në). Kontrolloni se a është ora e rregulluar në kohën e saktë ditore.

Shembull:

Koha momentale: 12:00

Koha e pjekjes: 2 orë

Përfundimi i pjekjes: ob 18:00

Së pari rregulloni KOHËZGJATJEN E FUNKSIONIMIT (2 orë). Në indikator shfaqet totali i kohës ditore dhe kohëzgjatja e funksionimit të furrës (14:00).

Tash e caktoni edhe PËRFUNDIMIN E FUNKSIONIMIT dhe e rregulloni kohën (18:00). Shtypni START për fillimin e pjekjes. Ora pret fillimin e pjekjes. Në indikator shfaqet paralajmërimi: "Fillimi i pjekjes është prolonguar. **Pjekja do të fillojë në orën 16.00.**"



Po poteku nastavljenege časa pečica samodejno preneha delovati. Oglasi se kratak zvočni signal, ki se po eni minuti izklopi sam.

Po nekaj minutah neaktivnosti aparat preide v stanje mirovanja – Standby. Prikaže se dnevni čas.


PËRGATITJA NË HAPA

Kjo mënyrë mundëson që në një proces të pjekjes të kombinoni **tre rregullime rradhëshe** të ndryshme.

Me përzgjedhjen e rregullimeve të ndryshme – përfundimit të funksionimit – mund të arrini që gjellat të përgatitura ashtu siç dëshironi vetë.



NË RREGULLIMET SHITESË me prekjen e emrit përzgjedhni simbolin **Përgatitja në hapa**.



Me prekjen dy herëshepërzgjedhni hapin e 2 dhe të 3.

Me prekjen e emrit konfirmoni ose shpërndan hapin.

Pas prekjes në butonin START, furra së pari fillon të funksionojë sipas hapit të 1 (hapi i përzgjedhur është i ngjyrosur kuq).

Pasiqë skadon koha e rregulluar, kyçet hapi i 2 dhe pas tij edhe hapi i 3, nëqoftëse e keni rregulluar.

 Nëqoftëse dëshironi që gjatë funksionimit të ndonjërit nga hapat ta fshini, së pari përzgjedhni hapin dhe pastaj me prekjen e emrit përzgjedhni kryqëzin. Këtë e vepron vetëm për hapat që akoma nuk kanë filluar.

HAPI I 3: NISJA E PJEKJES

Para fillimit të pjekjes, pulson butoni START/STOP.


Pjekjen e nisni me prekjen e butonit START.

Gjatë funksionimit, me prekje në indikator mund të ndryshoni disa rregullime (temperaturën, zgjatjen e funksionimit dhe programin në hapa).

Nëqoftëse dëshironi të ndryshoni rregullimet tjera ose të përfundoni pjekjen, prekni butonin START/STOP. Shfaqet paralajmërimi: **"Programi përkohësisht është ndalur. A dëshironi ta ndalni?"**



HAPI I 4: PËRF. I PJEKJES DHE SHKYÇJA E FURRËS



Pas përfundimit të pjekjes, shfaqet menya me simbolet.



Fundi

Përzgjedhni simbolin dhe përfundoni pjekjen. Në indikator shfaqet menya elementare.



Zgjate kohën e funksionimit


Me përzgjedhjen e simbolit në fjalë mund të zgjatni pjekjen. Mund të caktoni kohë të re të përfundimit të pjekjes (shiqo kapitullin FUNKSIONET KOHORE).



Shto në recetat e mia – ruaje

Mënyra mundëson që rregullimet e përzgjedhura t'i ruani në memorije të furrës dhe në të ardhmen t'i përdorni.

RUAJTJA E PROGRAMIT PERSONAL (RECETAT E MIA)



Përzgjedhni symbolin  dhe me prekjen e shkronjave përzgjedhni emrin. Sipas nevojës, me shigjetën e fshini shenjën.


Rregullimin e ruani me prekjen e butonit START/STOP.

 Recetat tuaja personale të adhuruara të cilat paraprakisht i keni ruajtur në memorje, kurdo mund t'i risjellni. Procesin e përzgjedhni dhe e rregulloni në menyne elementare **Recetat e mia**.


HAPI I 5: PËRZGJ. E FUNKSIONEVE SHITESË



Nëpër meny lëvizni me rrëshqitjen e gishtit majtas dhe djathtas.



Me prekje përzgjedhni menyën Shtesë. Shfaqet menya e funksioneve shtesë.



Pastrimi - Aqua Clean

Përdoret për heqjen e njollave dhe ushqimit në furrë. Hidhni 0.6 l ujë në një gotë ose enë të cekët për pjekje dhe vendoseni në rregullatorin e poshtëm. Pas 30 minutash, mbeturinat e ushqimit në emal të furrës zbuten dhe mund të fshihen me leckë të njomë. Funksionin në fjalë e përdorni kur është furra krejtësisht e ftohur! (Shiqo kapitullin Pastrimi dhe mirëmbajtja.)

Ngrohja

Përdoret për ruajtjen e ngrohtësisë së gjellave tash të përgatitura. Me përzgjedhjen e simbolit caktoni temperaturën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të ngrohjes.

Shkrirja

Te kjo mënyrë, ajri qarkullon pa nxehtësinë e kyçur. Funksionon vetëm ventilatori. Përdoret për shkrirjen e ngadalshme të ushqimit të ngrirë (tortave, kulaçeve, ëmbëlsirave, bukës dhe zhemljicave si dhe pemëve të ngrira)

Me përzgjedhjen e simbolit mund të caktoni llojin e ushqimit, peshën, kohën e fillimit dhe mbarimit të shkrirjes.

Në gjysmën e kohës së shkrirjes, copat e bukës i rrotulloni, përzini dhe ndani, nëqoftëse kanë qenë të ngrira njëra në tjetrën.


Parangrohja e shpejtë

Përdoret nëqoftëse dëshironi sa më parë të ngrohni furrën në temperaturën e dëshiruar. Nuk është e përshtatshme për pjekjen e gjellave.

Kur ngrohet furra në temperaturën e rregulluar, ngrohja përfundon dhe furra është e gatshme për pjekje në bazë të mënyrës së përzgjedhur të funksionimit.

Ngrohja e pjatave

Përdoret nëqoftëse dëshironi që servis (pjatat, filxhanat) paraprakisht të ngrohen, që ushqimi të mbetet i ngrohët më gjatë kohë. Me përzgjedhjen e simbolit mund të caktoni temperaturën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të ngrohjes.



Përzgjedhni simbolin dhe përfundoni pjekjen. Në indikator shfaqet menya elementare.



MBROJTJA E FËMIJVE

E kyçni me prekjen e butonit ÇELËSI. Në indikator shfaqet: **"Dera është e mbyllur."** Me prekjen e sërishme në këtë buton, siguresa shkyçet.



Nëqoftëse e rregulloni mbylljen, kur nuk keni të rregulluar asnjë funksion kohor (vetëm shfaqjen e kohës ditore), furra nuk do të funksionojë.

Nëqoftëse rregulloni mbrojtjen e fëmijve pas rregullimit të çfarëdo funksioni kohor, furra do të funksionojë normalisht, por nuk mund të ndryshoni rregullimet.

Kur është e kyçur mbrojtja e fëmijve, nuk mund të ndryshoni sistemet ose funksionet shtesë. Mund të shkyçni vetëm pjekjen.

Mbrojtja e fëmijve mbetet aktive edhe pas shkyçjes së furrës.

Nëqoftëse dëshironi të përzgjedhni sistemin e rinj, mbrojtjen e fëmijve nevojitet ta shkyçni.



NDRIÇIMI I FURRËS

Ndriçimi i furrës kyçet automatikisht kur e hapni derën ose e kyçni furrës.

Pas përfundimit të pjekjes, llamba ndriçon edhe për afërsisht 1 minutë.



RREGULLIMI I VËREJTËSIT

Vërejtësin mund të përdorni të pavarur, pavarësisht nga funksionimi i furrës. Rregullimi i mundëshëm më i gjatë është 10 orë. Pasi që skadon koha e rregulluar, paraqitet sinjali zanor, të cilin mund ta shkyçni me shtypjen e cilitdo buton, resp. pas një minute shkyçet vetë.




Me prekjen e shiritit të sipërm, kurdo mund të përzgjedhni ndriçimin dhe vërejtësin.


HAPI I 6: PËRZGJEDHJA E RREGULLIMEVE TË PËRGJITHSHME



Nëpër meny lëvizni me rrëshqitjen e gishtit majtas dhe djathtas.



Me prekje përzgjedhni menyën **Rregullimet**.



Me prekje përzgjedhni menyën Rregullimet.

Gjuha

Përzgjedhni gjuhën në të cilën dëshironi të shfaqen tekstet në indikator.

Koha

Kohën ditore, resp. orën nevojitet ta rregulloni te kyçja e parë e aparatit në rrjetën elektrike ose nëqoftëse aparatin për më gjatë kohë (më gjatë se një javë) e shkyçni nga rrjeta elektrike. Rregulloni ORËN – kohën. Pastaj në fushën KOHA mund të rregulloni mënyrën e shfaqjes së orës: **digjital ose analog**.

Tingulli

Lartësinë e sinjalit zanor mund të rregulloni kur nuk është aktiv asnjë funksion kohor (e shfaqur vetëm koha ditore).

Në këtë meny mund të përzgjedhni ndërmjet të mundësive në fjalë:

Lartësia e zërit dhe zgjatja e alarmit.

Ekрани

Në këtë meny mund të rregulloni:

Ndriçueshmëria e ekranit

Mënyra e natës – caktoni orën deri kur dëshironi të jetë indikator i shkyçur.

Rregullimet tjera

Shkyçja e ndriçimit të furrës.



Pas dështimit të energjisë elektrike ose shkyçjes së aparatit, të gjitha rregullimet shtesë dhe personale ruhen.

PËRSHKRIMI I SISTEMEVE DHE TABELËS SË PJEKJES

Nëqoftëse në tabelën e pjekjes nuk gjeni ushqimin e përzgjedhur, kërkoni të dhënat për ushqimin e ngjajshëm.

Të dhënat janë të shfaqura për pjekje një nivelore të ushqimit në furrë.

Temperaturat janë të cekura në vlera të ulëta dhe të larta. Së pari rregulloni temperaturën e ulët; nëqoftëse ushqimi nuk skuqet mjaftueshëm, herën e ardhshme lartësoni temperaturën.

Kohët e pjekjes janë si kornizë dhe mund të ndryshojnë te kushtet e caktuara.

Shenja * domethënë që nevojitet të parangrohni furrën në sistemin e përzgjedhur të pjekjes.

Furrën e parangrohni vetëm nëqoftëse kështu është cekur në recetën ose në tabelat e këtij doracaku për përdorim. Te ngrohja e furrës së zbrazët shpenzohet shumë energji, prandaj, me pjekjen e vazhdueshme të më shumë llojeve të ëmbëlsirave ose picave kursejmë shumë energji, sepse furra është e nxehtë.


Kur përdorni letër për pjekje, kontrolloni se a është ai rezistent te temperaturat e larta.

Te pjekja e copave të mëdha të mishit ose ëmbëlsirave, në furrë do të shkaktohet sasi e madhe e avullit, e kjo në derën e furrës shkakton kondens. Kjo është dukuri normale, e cila nuk ndikon në funksionimin e aparatit. Pas përfundimit të pjekjes, fshini derën dhe xhamin e derës deri sa të thahen.

Kah fundi i pjekjes, furrën mund të shkyçni për afërsisht 10 minuta para përfundimit të pjekjes, që të shfrytëzoni nxehtjen e akumuluar dhe kështu kurseni energji.

Mos ftohni gjellat në furrën e mbyllur, kështu i shmangeni vesimit.

NXEHËSI I EPËRM DHE I POSHTËM



Nxehësit në anën e epërme dhe të poshtme të furrës njëtrajtshëm transmetojnë nxehjen në brendësi të furrës.

Pjekja e mishit:

Lejohet përdorimi i enëve nga emali, qelqi zjarr rezistues, argjyli ose nga hekuri. Tepsitë nga çeliku jokorodues nuk janë të përshtatshme, sepse shumë fuqishëm e refuzojnë ngrohjen.

Te pjekja nevojitet të siguroni mjaft lëndë fluide që të mos digjet mishi. Gjatë pjekjes, rrotullojeni. Nëqoftëse e mbuloni fërlikun, do të mbetet më i lëngshëm.

Lloji i ushqimit	Pesha (g)	Udhëzimi (nga poshtë)	Temperatura (°C)	Koha e gatimit (min)
MISHI				
